



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 710, datë 04.12.2023

PËR

CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT PËR PROCEDIMIN DISIPLINOR NR. 4/2023, TË FILLUAR NGA INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË, NDAJ MAGJISTRATIT Z. {...} ME FUNKSION GJYQATAR PRANË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË LUSHNJË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të Ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, në nenet 138 e vijues të Ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 16 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes, relacionin e përgatitur, pas shortit të hedhur

VENDOSI:

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, Z. Ridvan Hado, në cilësinë e relatorit për procedimin disiplinor nr. 4/2023, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR